

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Ligjin Nr. 04/L-223, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 02/2017

NXITJET DHE MOTIVIMET PËR MARRJE TË KUPONËVE FISKAL

QËLLIMI

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është përcaktimi i procedurave për realizimin e së drejtës së konsumatorëve, sipas Udhëzimit Administrativ MF-Nr. 1/2017 për plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MF-Nr 01/2015 për shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale .

BAZA LIGJORE

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ MF. Nr. 1/2017 për plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MF-Nr. 01/2015 për shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale .

PËRKUFIZIMET

Përkufizimet në vijim vlejnë për qëllime të këtij Shpjegimi Publik:

Pajisje Elektronike Fiskale - e njohur si PEF apo arka fiskale, do të thotë një pajisje apo sistem elektronik i kompjuterizuar, që përdoret për regjistrim të sigurt dhe lëshim të kuponëve fiskal për transaksionet me pakicë. Termi “Pajisje Elektronike Fiskale” përfshinë ato pajisje elektronike siç janë arkat fiskale, printerët fiskal dhe pajisjet e ngjashme.

Kuponi fiskal - është dokument në letër i lëshuar nga pajisja elektronike fiskale e cila është nga lloji i aprovuar dhe e cila është e regjistruar zyrtarisht në Administratën Tatimore. Kuponi fiskal është dokument me të cilin regjistrohet shitblerja e mallrave dhe shërbimeve në pikën e shitjes. Kuponi fiskal duhet të ketë se paku 18 karaktere për rresht të printuar dhe duhet të përfundojë me logon fiskale.

LOGO E BIZNESIT	
NR. FISKAL 000000000	
NR. TVSH 300000000	
Artikulli numër 1	1 x 2,35
	2,35
Artikulli numër 2	1 x 2,35
	2,35
Artikulli numër 3	1 x 2,35
	2,35

TOTALI NE EURO	6,45
CHATELE	1,45
TVSH 0+10,00%	0,88
TOT. PA TVSH	1,33
ARTIKULLI 24	
Paragjori super: 100400	
20055035	23-09-2012 10:55:24
NR. SERIK	300000000
KUPON FISKAL NR. 0007	
RKS	
MEF	

Letërnjoftim - nënkupton dokumentin zyrtar me të cilin shtetasi i Republikës së Kosovës vërteton identitetin e tij personal: shtetësinë, gjininë, datën e lindjes, vendlindjen si dhe adresën ku banon (vendqëndrimin).

Letërnjoftimi për të huaj - është dokument zyrtar më të cilin pajiset qytetari i cili në kohën e dhënies së këtij letërnjoftimi e ka të lejuar qëndrimin e përkohshëm apo qëndrimin e përhershëm në Republikën e Kosovës.

Qytetar - është shtetasi i Republikës së Kosovës apo i huaji.

Vlera totale – përfshinë vlerën e përgjithshme të kuponit fiskal. Nëse kuponi është i lëshuar me TVSh, nënkuptohet edhe përfshirja e TVSh-së.

Xhirollogari – Numri i llogarisë bankare ku do të derdhën mjetet e rimbursuara nga grumbullimi i kuponëve fiskal.

Numri i Plikos – është numri i cili gjenerohet në mënyrë automatike nga sistemi i ATK-së me rastin e plotësimit të aplikacionit nga qytetari.

Numri Potencial Fitues- është numër i cili gjenerohet në mënyrë automatike nga Sistem i ATK-së në bazë të një algoritmi të përcaktuar nga ATK, duke u bazuar në Numrin e Plikos, Emrin dhe Mbiemrin e qytetarit;

NXITJET DHE MOTIVIMET PËR MARRJE TË KUPONËVE FISKAL

Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që aplikojnë për Rimbursim nga grumbullimi i kuponëve fiskal në muajin pasues të çdo tre mujori, do të kenë mundësi të rimbursohen në qoftë se përmbushen kriteret si në vijim:

1. Aplikimi bëhet on-line në sistemin e ATK-së, duke plotësuar informatat të cilat kërkohen në aplikacion, brenda afatit të përcaktuar.
2. Në qoftë se i takon Numrit Potencial Fitues të tërhequr;
3. Dorëzon plikon me kupon fiskal së bashku me të dhënave që janë plotësuar në momentin e aplikimit;
4. Numri minimal i kuponëve fiskal të dorëzuar duhet të jetë 60 kuponë, me shumën minimale dyqindpesëdhjetë euro (250€);
5. Numri personal i aplikuesit dhe llogaria bankare duhet të jenë të personit të njëjtë;

Fituesit potencial do të rimbursohen me dhjetë përqindë (10%) të vlerës së deklaruar, por jo më shumë se njëqind euro (100 €).



TË DREJTË PËR TË PËRFITUAR NGA GRUMBULLIMI I KUPONËVE FISKAL

Për të përfituar nga grumbullimi i kuponëve fiskal, të drejtë ka secili qytetar pavarësisht moshës. Mund të aplikojnë qytetarët që kanë numër personal të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, qoftë: Letërnjoftim, Ekstrakt apo Certifikatë.

- Aplikimi bëhet on-line në sistemin e ATK-së, duke plotësuar informatat të cilat kërkohen në aplikacion, brenda afatit të përcaktuar. Aplikimi bëhet vetëm një herë për të njëjtën periudhë duke u bazuar në Numrin Personal të aplikuesit;
- Numri Potencial Fitues do të gjenerohet nga Sistem i ATK-s në bazë të një algoritmi të përcaktuar nga ATK, duke u bazuar në Numrin e Plikos, Emrin dhe Mbiemrin (në rastet kur qytetari posedon dy mbiemra do të merret për bazë vetëm i pari) e qytetarit;
- Pas përfundimit të afatit të aplikimit, në njërën nga datat 1 deri më 10 të muajit pasues, ATK në bashkëpunim bashkëpunim me Lotaria e Kosovës do të organizoj tërheqjen e Fitueseve Potencial (FP), përmes Televizionit Publik (TV) të Kosovës.
 - Në procesin e tërheqjes do të kemi tre (3) Numra Potencial Fitues, në qoftë se numri i fituesve është mbi 999 deri 4500 ;
 - Nëse numri i fituesve të tërhequr nga Numra Potencial Fitues është më e vogël se 1000 atëherë duhet të tërhiqet edhe Numra Potencial Fitues shtesë deri në plotësimin e kushtit të paraparë.
 - Çdo Numër Potencial Fitues i tërhequr do të ketë maksimum njëmijepesëqind (1,500) fitues, në të kundërtën tërheqja përsëritet;
- Aplikuesi me Numrin Potencial Fitues, të tërhequr në transmetimin e drejtpërdrejtë në TV, plikon e tij/sajë me kuponë fiskal duhet ta dorëzojë fizikisht të mbyllur së bashku me të dhënat e aplikimit, në njërën nga Drejtoritë Regjionale të ATK-së.

PERIUDHAT E GRUMBULLIMIT TË KUPONËVE FISKAL

Grumbullimi i kuponëve fiskal duhet të bëhet në periudha tremujore, si në vijim:

- Tremujori i parë (TM1) përfshinë periudhën Janar, Shkurt, Mars;
- Tremujori i dytë (TM2) përfshinë periudhën Prill, Maj, Qershor;
- Tremujori i tretë (TM3) përfshinë periudhën Korrik, Gusht, Shtator, dhe
- Tremujori i katërt (TM4) përfshinë periudhën Tetor, Nëntor, Dhjetor.



MËNYRA E APLIKIMIT

Qytetari për të aplikuar është i obliguar që të plotësoj aplikacionin për rimbursim të mjeteve nga grumbullimi i kuponëve fiskal. Aplikacionin duhet ta plotësoj në mënyrë elektronike përmes ueb-faqes së Administratës Tatimore të Kosovës www.atk-ks.org.

Hapat për të plotësuar këtë aplikacion, janë si në vijim:

Shembull:

The screenshot shows a web form with the following fields and labels:

- Numri i Plikos (Ju lutem shenojeni këtë numër në pliko!) 1940579
- Numri i Personal
- Emri
- Mbiemri
- Numri i llogarisë bankare
- Emri Bankës
- Numri i telefonit
- Email adresa
- Numri i kuponëve
- Vlera totale e gjithë kuponëve

A red button labeled "Dërgo" is located at the bottom right of the form.

Pasi të plotësohet aplikacioni i mësipërm dhe është shtypur butoni “Dërgo”, pos informacioneve tjera të aplikuesit do të shfaqet edhe Numri Potencial Fitues si në shembullin e mëposhtëm:

I nderuar qytetarë, Numri Potencial Fitues për ju është:

452

Informacionet tjera së bashku me Numrin Potencial Fitues do t'i pranoni në e-mail.

Sqarim:

Të gjithë qytetarët, të cilët nuk mund të plotësojnë aplikacionin e mësipërm për arsye të ndryshme (mos pajisje me kompjuter, internet, etj.) mund të drejtohen në cilëndo nga Drejtoritë Regjionale të ATK-së, ku do të ofrohen shërbime me qëllim të realizimit të kërkesës së tyre.



AFATI PËR APLIKIM

- Aplikimi për kuponët e periudhës TM1, behet nga data 1 Prill deri më 30 Prill të vitit përkatës.
- Aplikimi për kuponët e periudhës TM2, bëhet nga data 1 Korrik deri më 31 Korrik të vitit përkatës.
- Aplikimi për kuponët e periudhës TM3, bëhet nga data 1 Tetor deri më 31 Tetor të vitit përkatës.
- Aplikimi për kuponët e periudhës TM4, bëhet nga data 1 Janar deri më 31 Janar të vitit vijues.

AFATI PËR TËRHEJEN E NUMRAVE POTENCIAL FITUES DHE PUBLIKIMI

Pas përfundimit të procesit të aplikimit, në njërin nga datat 1 deri më 10 të muajit pasues, ATK në bashkëpunim me Lotarinë e Kosovës përmes Televizionit Publik (TV) të Kosovës , do të organizon tërheqjen e tre (3) apo më shumë Numrave Potencial Fitues varësisht nga plotësimi i kriterëve të lartë cekura.

Nëse shuma e fituesve të tërhequr nga Numrat Potencial Fitues është më e vogël se 1000, atëherë duhet të tërhiqet edhe Numri Potencial Fitues shtesë deri në plotësimin e kushtit të paraparë

Çdo Numër Potencial Fitues i tërhequr do të ketë maksimum njëmijepesëqind (1,500) fitues, në të kundërtën tërheqja përsëritet.

Lista me numra të plikove potenciale fituese do të publikohet në web faqen e ATK-së www.atk-ks.org.


AFATI PËR DORËZIMIN E PLIKOS

Pas përfundimit të procesit të tërheqjes së Numrave Potencial Fitues, qytetaret të cilët posedojnë Numrin Potencial Fitues të përzgjedhur nga tërheqja, plikon me kuponë fiskal së bashku me të dhënat e aplikimit duhet të dorëzojnë fizikisht të mbyllur, në njërin nga Drejtoritë Regjionale të ATK-së, brenda afatit prej pesë (5) ditë pune pas publikimit të listës në web faqe të ATK-së.

Për dorëzimin e plikos duhet të ndiqni hapat si në vijim:

- Vendos të gjithë kuponët e grumbulluar në një pliko me të cilën keni aplikuar;
- Shëno numrin e plikos të gjeneruar nga sistemi në anën e jashtme të plikos (zarfit) si dhe Numrin Potencial Fitues (NPF);

- Brenda në pliko vendos të dhënat personale që keni dhënë gjatë aplikimit.



Me rastin e dorëzimit, pliko duhet gjithësesi të përmbaj **numrin e plikos dhe Numrin Potencial Fitues**, të gjeneruar me rastin e aplikimit përmes sistemit, në të kundërtën nuk do të pranohet në sportelet e shërbimit në ATK.


Vërejtje:

Asnjë kupon fiskal i bartur nga një periudhë në një periudhë tjetër, nuk do të jetë i vlefshëm për qëllime të rimbursimit.

PRANIMI I PLIKOVE

Zyrtari tatimor obligohet të pranon plikot e qytetarëve sipas listës së publikuar në web faqe të ATK-së, të cilët janë përzgjedhur gjatë procesit të tërheqjes së Numrave Potencial Fitues, vetëm pasi të verifikoj informatat e shënuara në pliko me informatat që janë gjeneruar gjatë aplikimit në sistem, në të kundërtën pliko do të refuzohet.

Pasi që të bëhet pranimi i plikos, zyrtari tatimor ka për obligim të pajisë qytetarin me dëshminë e pranimit të plikos, me të dhënat:

 DËSHMI PËR PRANIM TË PLIKOS ME KUPONA FISKAL	
<input type="text" value="Nr. I Plikos"/>	<input type="text" value="Nr. Potencial Fitues"/>
Data e pranimit:	



VERIFIKIMI I PLIKOVE

Pas pranimit të plikove, ATK do të bëjë verifikimin e kuponëve fiskal si: vlefshmërinë, shumën, numrin e kuponëve fiskal si dhe shënimet personale në aplikacion.

Pliko e cila nuk përmbushë kriteret e lartë shënuara do të eliminohet nga e drejta rimbursimit.

AFATI PËR RIMBURSIMIN E MJETEVE

Rimbursimi i mjeteve për të gjitha plikot që janë në rregull, do të bëhet brenda afateve ligjore.

HYRJA NE FUQI

Ky Vendim Shpjegues Publik fillon se zbatuari nga data e hyrjes ne fuqi te Udhëzimit Administrativ MF. Nr. 1/2017 për plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MF-Nr. 01/2015 për shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale, duke shfuqizuar Vendimin Shpjegues Publik Nr. 02/2015 Procedurat per zbatimin e nenit 26 te Udhëzimit Administrativ MF. Nr. 01/2015 Dorëzimi i Kuponëve Fiskal dhe Rimbursimi i Mjeteve.

Data: 3/7/2017



Drejtori i Përgjithshëm, ATK

(Sakip Imeri)